

### Vështrim mbi tregjet

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, viti 2021

### Publikime Profesionale

- BIS      Modelet e biznesit të bazuara në platforma dhe gjithëpërfshirja financiare
- ESMA      Nisin konsultimet për regjimin pilot për Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë
- OECD      Publikohen: “Vështrimi ekonomik i OECD” - Dhjetor 2021  
“Një vështrim mbi pensionet 2021”
- XPRIMM      Publikohet “Sigurimi i Pronës për vitin 2020 dhe gjysmën e parë të vitit 2021”

### Informacione Ndërkombëtare

- Bullgari
- Kroaci
- Itali
- Mali i Zi
- Maqedoni e Veriut
- Poloni
- Slloveni

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Ecuria e tregut të sigurimeve në Shqipëri, viti 2021


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2021 kapën vlerën 19,268 milionë lekë, ose 16.02% më shumë se në vitin 2020. Gjatë vitit 2021, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,173,520 me një rritje prej 22.7% krahasuar me një vit më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.44% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 7.42%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.35% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.65% të totalit të tregut.

Gjatë vitit 2021, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,666 milionë lekë, ose 11.08% më pak se në vitin 2020, ndikuar kryesisht nga pagesa e pjesës më të madhe të dëmshpërblimeve për tërmetet e fund vitit 2019.

Ndërkohë dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për vitin 2021 kapën vlerën 3,986 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.25% krahasuar me vitin 2020.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar – Dhjetor 2021 (Në %)



Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik gjatë vitit 2021 kapën vlerën 3,986 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 20.25% krahasuar me vitin 2020.

The screenshot shows the BIS website interface. At the top, there is a search bar and navigation links for 'About BIS', 'Research & publications', 'Committees & associations', 'Central bank hub', 'Statistics', 'Banking services', and 'Media & speeches'. The main content area features a sidebar with 'Research & publications' and 'Working Papers' highlighted. The main article is titled 'Platform-based business models and financial inclusion' by Karen Croxson, Jon Frost, Leonardo Gambacorta, and Tommaso Valletti, dated 10 January 2022. It includes a summary, focus, and contribution sections.

## Modelet e biznesit të bazuara në platforma dhe gjithëpërfshirja financiare



Karen Croxson,  
Jon Frost,  
Leonardo Gambacorta  
Tommaso Valletti

*(BIS publikon materiale diskutimi – Më poshtë është përmbledhja dhe pikat kryesore të punimit. Në punim theksohet se lojtarët e rinj në financa përfshijnë fintech dhe firmat e mëdha të teknologjisë me platforma dixhitale në tregtinë elektronike, kërkimin ose mediat sociale. Gjithnjë e më shumë, institucionet financiare ekzistuese po miratojnë modele biznesi të bazuara në platforma. Platformat dixhitale operojnë në tregje të shumëanshme, duke përdorur të dhëna të mëdha për të përshtatur grupe të ndryshme klientësh. (p.sh. përdoruesit dhe ofruesit). Ky punim vlerëson se si këto modelet mund të ndikojnë në përfshirjen financiare, konkurrencën, stabilitetin financiar dhe mbrojtjen e konsumatorëve.)*

### Abstrakt

Tre lloje të platformave digjitale po zgjerohen në shërbimet financiare:

- i. Hyrjet në fintech;
- ii. Firmat e mëdha të teknologjisë; dhe
- iii. Gjithnjë e më shumë, institucionet financiare ekzistuese me modele biznesi të bazuara në platforma.

Këto platforma mund të ulin në mënyrë dramatike kostot dhe në këtë mënyrë të ndihmojnë gjithëpërfshirjen financiare, por të njëjtat veçori mund të krijojnë monopole dhe oligopole digjitale.

Platformat digjitale operojnë në tregje të shumëanshme dhe mbështeten në mënyrë thelbësore në të dhënat e mëdha (Big Data). Kjo çon në efekte specifike të rrjeteve, kthimin në ekonominë e shkallës dhe në qëllime, dhe këmbime politikave drejtuese.

vijon...

...

## **Modelet e biznesit të bazuara në platforma dhe gjithëpërfshirja financiare**

...

Për të siguruar përfitimet e platformave teknologjike duke zbutur rreziqet, politikëbërësit mund:

- (i) Të zbatojnë rregulloret ekzistuese financiare, antitrust dhe të privatësisë;
- (ii) Të adaptojnë rregulloret të vjetra dhe të miratojnë rregulloret të reja, duke kombinuar një qasje të bazuar në aktivitet dhe entitet; dhe/ose
- (iii) Të ofrojnë infrastruktura të reja publike. Këto të fundit përfshijnë identitetin dixhital, sistemet e pagesave të shpejta me pakicë dhe monedhat dixhitale të bankës qendrore (CBDC).

Këto infrastruktura publike, si dhe rregullat *ex ante* të konkurrencës (rregulla të bazuara më shumë në parashikime se sa në rezultate konkrete) dhe transportueshmëria e të dhënave, janë veçanërisht premtuese.

Megjithatë, për të arritur objektivat e tyre të politikës, bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë duhet të koordinohen me autoritetet e konkurrencës dhe mbrojtjen e të dhënave.

### **Gjetjet**

Studimi tregon se platformat digjitale kanë ndihmuar arritjen e rezultateve mbresëlënëse në përfshirjen financiare, si në tregjet në zhvillim, në ekonomitë e zhvilluara, ashtu edhe në ato të përparuara si Mbretëria e Bashkuar.

Studimi jep edhe prova të tendencës së platformave dixhitale për të dominuar në tregje specifike. Ai argumenton se një qasje e politikës *ex ante* ndaj konkurrencës, transportueshmërisë së të dhënave dhe infrastrukturave publike (p.sh. për identitetin digjital, shpejtësia në pagesat me pakicë dhe monedhat dixhitale potencialisht të bankës qendrore) mund të jetë premtuese.

Studimi argumenton se pavarësisht nga qasja e zgjedhur, koordinimi nga bankat qendrore dhe rregullatorët financiarë me autoritetet e konkurrencës dhe të mbrojtjes së të dhënave duhet të garantohet.

## Call for evidence

DLT Pilot Regime and review of MiFIR regulatory technical standards on transparency and reporting



### ESMA nis konsultimet për regjimin pilot për Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë – DLT

Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (ESMA) u ka kërkuar të gjitha palëve të interesuara pikëpamjet e tyre në lidhje me regjim rregullator pilot për Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë (*Distributed Ledger Technology, DLT*).

Rregullorja për një regjim pilot për infrastrukturën e tregut të bazuar në Teknologjinë e Regjistrave të Shpërndarë ("*Pilot DLT*") synon zhvillimin e tregtimit dhe shlyerjes për letrat me vlerë të '*tokenizuara*'. Piloti DLT kërkon që ESMA të vlerësojë nëse standardet teknike rregullatore (*Regulatory Technical Standards, RTS*) të zhvilluara nën MiFIR në lidhje me disa kërkesa të transparencës dhe raportimit të të dhënave para dhe pas tregtisë duhet të ndryshohen për t'u zbatuar në mënyrë sa më efektive edhe për letrat me vlerë të emetuara, të tregtuara dhe të regjistruara në DLT.

Palët e interesuara janë ftuar të japin komente duke nisur prej datës 4 janar deri më 4 mars 2022. Bazuar në komentet e marra, ESMA do të reflektojë nëse janë të nevojshme ndryshime në RTS. Nëse ESMA arrin në përfundimin se ndryshime të tilla janë të nevojshme, ESMA do të konsultojë publikun mbi propozimin e saj në një dokument konsultimi përpara se të dorëzojë draftin përfundimtar të RTS në Komisionin Evropian për miratim.



## — The global recovery is **strong** but **imbalanced**

Output in most OECD countries has now surpassed its late-2019 level and is converging on its pre-pandemic path but lower-income economies, particularly those where vaccination rates are low, are at risk of being left behind.

The unevenness of the recovery is widespread

### 1. Publikohet “Vështrimi ekonomik i OECD” dhjetor 2021

*A Balancing Act - OECD Economic Outlook, December 2021*

OECD ka publikuar në dhjetor 2021 studimin mbi ecurinë e ekonomisë globale. Sipas këtij studimi “... Ekonomia globale po rimëkëmbet dhe fuqizohet, por është e pabalancuar.”

Prodhimi në shumicën e vendeve të OECD-së tani ka tejkaluar nivelin e tij të fundit të vitit 2019 dhe po konvergjon në rrugën e tij para pandemisë, por ekonomitë me të ardhura më të ulëta, veçanërisht ato ku normat e vaksinimit janë të ulëta, rrezikohen të mbeten prapa.

#### **Pabarazia e rimëkëmbjes është e përhapur**

Rimëkëmbja është gjithashtu e pabarabartë brenda ekonomive të përparuara. Punësimi është ende relativisht i dobët në Shtetet e Bashkuara, por tashmë është më i lartë se niveli i tij para pandemisë në Eurozonë. Në të njëjtën kohë, Prodhimi i Brendshëm Bruto i Shteteve të Bashkuara është rikuperuar më shpejt se ai në Evropë. Modele të ndryshme mbrojtjeje nënkuptojnë sfida të ndryshme në të ardhmen.

Tregu i punës është i pabalancuar. Shumë njerëz po luftojnë për të gjetur punë, por bizneset në një numër sektorësh kanë vështirësi në rekrutimin e punëtorëve. Aftësitë e kërkuara në vazhden e krizës nuk janë domosdoshmërisht të njëjta si më parë.

Mungesa e punëtorëve në disa sektorë pasqyron gjithashtu një rënie të shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në shumicën e vendeve të OECD. Pjesëmarrja në rritjen e ofertës së punës pritet të normalizohet pasi të zbehen efektet e pandemisë, duke ndihmuar në mbajtjen e moderuar të rritjes së pagave.

Pabarazitë mbeten gjithashtu në të gjithë industrinë, me sektorë të varur nga kontaktet ndërpersonale të tillë si udhëtimi, turizmi dhe argëtimi që vazhdojnë të vuajnë, ndërsa kërkesa për mallra të konsumit ka qenë e fortë, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara.

...vijon

## Publikohet “Vështrimi ekonomik i OECD” dhjetor 2021

*A Balancing Act - OECD Economic Outlook, December 2021*

### Kërkesa e fortë për mallra përballet me pengesa në ofertë

Rikthimi po humbet njëfarë vullti pasi rritja e kërkesës për mallra ka hasur në pengesa në zinxhirët e prodhimit. Presionet inflacioniste janë shfaqur në të gjitha ekonomitë, si:

- Ndërprerjet në tregjet e energjisë, ushqimeve dhe mallrave kanë rritur çmimet;
- Çmimet e larta të energjisë dhe mungesat e karburanteve po kufizojnë prodhimin e materialeve kryesore dhe pengesat e mallrave të ndërmjetme në zinxhirët e prodhimit po çojnë në mungesa më të përgjithshme të mallrave.

Presionet e përtëritura inflacioniste rrezikojnë të zgjasin më shumë sesa pritej disa muaj më parë. Rritja e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë po godet veçanërisht familjet me të ardhura të ulëta.

### 2. Publikohet “Një vështrim mbi pensionet 2021”

Në dhjetor OECD publikoi studimin “Një vështrim mbi pensionet përgjatë vitit 2021”. Sipas analizës së bërë nga OECD, pandemia e COVID-19 ndikoi shumë tek të moshuarit dhe pensionistët. Megjithatë, në vendet e OECD, ata i kanë pasur pagesat e pensioneve të tyre të mbrojtura mirë. Sipas një raporti tjetër të OECD-së, edhe të drejtat e pensioneve të ardhshme janë gjithashtu të mbrojtura mirë, falë reagimit të jashtëzakonshëm të politikës ndaj krizës.

Studimi “Një vështrim mbi pensionet përgjatë vitit 2021” nënvizon se megjithatë vazhdon presioni financiar afatgjatë nga plakja e popullsisë. Financat e pensioneve u përkeqësuan gjatë pandemisë për shkak të kontributeve të humbura dhe mungesat janë mbuluar kryesisht nga buxhetet e shteteve. Vendosja e sistemeve të pensioneve në bazë solide për të ardhmen, do të kërkojë vendime të dhimbshme politike.

Megjithëse, rritja e jetëgjatësisë është ngadalësuar që nga viti 2010, ritmi i plakjes parashikohet të jetë i shpejtë gjatë dy dekadave të ardhshme. Madhësia e popullsisë në moshë pune parashikohet të bjerë me më shumë se një të katërtën deri në vitin 2060, në shumicën e vendeve të Evropës Jugore, Qendrore dhe Lindore, si dhe në Japoni dhe Kore.

Të rinjtë janë prekur rëndë nga kriza dhe mund të shohin ulje të përfitimeve të tyre në të ardhmen, veçanërisht nëse pandemia rezulton në vështirësi në ndërtimin e karrierës së tyre. Lejimi i aksesit të hershëm në kursimet e pensioneve për të kompensuar vështirësitë ekonomike, siç vërehet në disa vende si Kili, mund të gjenerojnë gjithashtu probleme në terma afatgjata: nëse kursimet më të larta të ardhshme nuk do të kompensojnë këto tërheqje, përfitimet e ulëta të pensionit do të jenë pasoja.





## Xprimm publikon “Sigurimi i Pronës për vitin 2020 e gjysmën e parë të vitit 2021”

**xprimm.com**  
INSURANCE IN CEE • SEE • CIS

<http://xprimmpublications.com/books/mmqm/#p=6>

Në një raport të saj të fundit Xprimm publikon një analizë të thelluar të industrisë së sigurimit të pronës për 32 vende të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore si edhe ish republikat e Bashkimit Sovjetik.

Në editorialin e saj që shoqëron këtë botim, “Një periudhe e mundimshme, midis tërmeteve dhe ngjarjeve të tjera të mëdha të motit” Daniela Ghetu thekson se ngjarjet e kësaj periudhe nxorën në pah nevojën për sigurimin e vazhdueshëm të pronës sikurse edhe nevojën për zvogëlimin e mundësisë së pabarabartë për t’u përfshirë në skemat e sigurimeve.

Në shkrim ajo jep të dhëna statistikore mbi vëllimin e primeve të shkruara bruto në klasat 8 dhe 9 të sigurimeve të pronës dhe dëmeve të tjera në pronë, ashtu si edhe dëmet e paguara bruto për sigurimin e pronës. Sipas informacionit statistikor ndër vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore si edhe ndër ish republikat e Bashkimit Sovjetik (CEE, SEE, ex-USSR) pesë ishin vendet me volumin më të madh të sigurimit të pronës, Polonia, Republika Çeke, Hungari, Sllovaki dhe Rumania të cilat së bashku zinin 75.7% të vëllimit të primeve të shkruara bruto të rajonit.

Botimi jep edhe një kronologji të ngjarjeve të ndodhura që lidhen me sigurimin pronës dhe katastrofat natyrore në vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore si edhe nga ish republikat e Bashkimit Sovjetik.



## INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

---

### **BULLGARI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave zyrtare të publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare – FSC të Bullgarisë, tregu bullgar i sigurimeve arriti në 2.44 miliardë BGN (monedha lokale), ose rreth 1.24 miliardë euro në fund të shtatorit 2021. Ky vëllim i primeve të shkruara bruto për 9-mujorin e 2021 është 12.7% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 34% në terma vjetore duke arritur në 440 milionë BGN. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga rritja treshifrore e raportuar për policat e sigurimit të Jetës të lidhura me skemat e kursimit, UL të cilët patën një rritje prej 138% në terma vjetore krahasuar me një vit më parë.

Për të njëjtën periudhë krahasuese, në tregun e sigurimit të Jo-Jetës primet e shkruara bruto u rritën me 9% duke arritur në 2 miliardë BGN.

### **KROACI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas informacioneve nga Byroja Kroate e Sigurimeve, SeeNews raporton se gjatë periudhës janar - nëntor 2021, vëllimi i primeve të shkruara bruto të siguruesve me bazë në Kroaci u rrit 11.87% në vit dhe arriti në 10.74 miliardë HRK ose rreth 1.4 miliardë euro. Segmenti i tregut të sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 12.65% duke arritur në 8.12 miliardë HRK(monedha lokale). Në të njëjtën kohë, sigurimet e Jetës u rritën me 9.51%, duke arritur në 2.62 miliardë HRK. Tregu i sigurimeve në vend, në fund të nëntorit kishin 15 sigurues të regjistruar.

## ITALI

Paralajmërim i Autoritetit Italian CONSOB

[www.consob.it](http://www.consob.it)

Rregullatori italian i shërbimeve financiare CONSOB ka paralajmëruar lidhur me risqet që vijnë nga investimi në kriptomonedhat. Më 17 janar, CONSOB ka urdhëruar mbylljen e 5 faqeve të internetit që ofrojnë shërbime financiare në mënyrë të paligjshme. Lidhur me këtë mbyllje, rregullatori italian shfrytëzoi kompetencat e reja që rezultojnë nga "Decreto Crescita" (Dekreti i Rritjes; Ligji nr. 58, datë 28 qershor 2019). Mbi bazën e këtij dekreti CONSOB mund të urdhërojë ofruesit e shërbimeve të internetit të bllokojnë aksesin nga Italia në faqet e internetit që ofrojnë shërbime financiare pa autorizimin e duhur.

Më poshtë janë faqet që CONSOB ka urdhëruar të fshihen:

- *Crypto Solution Ltd (faqja e internetit <https://cryptopro24.com> dhe faqja e saj <https://client.cryptopro24.com>);*
- *Agrico Holdings Limited (faqja e internetit <https://investagrigo.com> dhe faqja e saj <https://client.investagrigo.com>);*
- *Wirexinvest Invest Limited dhe Wirex Uab (faqja e internetit [www.wirexinvest24.com](http://www.wirexinvest24.com) dhe faqja e saj <https://webtrade.wirexinvest24.com>);*
- *Strat Ltd (faqja e internetit [www.finexoinv.io](http://www.finexoinv.io) dhe faqja e saj <https://client.finexoinv.io>);*
- *Invest Area Ltd (faqja e internetit <https://investarea.com> dhe faqja e saj <https://accounts.investarea.com>).*

Numri i faqeve të fshira që nga korriku 2019, kur CONSOB mori fuqinë për të urdhëruar mbylljen e faqeve të internetit të ndërmjetësve financiarë mashtrues, është rritur në 605.

Rregullatori italian i shërbimeve financiare CONSOB ka paralajmëruar lidhur me risqet që vijnë nga investimi në kriptomonedhat nga një numër gjithnjë e më i madh i qytetarëve të cilët nuk kanë njohuri të thelluara në investimin në skema financiare. CONSOB tërheq vëmendjen e investitorëve për rëndësinë e kujdesit më të madh për të bërë zgjedhje të informuara investimi, me sjellje të arsyeshme, duke pasur si thelbësore mbrojtjen e kursimeve të gjithsecilit. Për faqet e internetit që ofrojnë shërbime financiare, duhet të bëhet kontrolli paraprakisht nëse operatori me të cilin po investoni është i autorizuar dhe që për ofertat e produkteve financiare të jenë publikuar prospektet e duhura.

## MALI I ZI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Këshilli Drejtues i Agjencisë për Mbikëqyrjen e Sigurimeve në Malin e Zi ka miratuar vendimin për shumën e kontributit të rregullt në Fondin e Garancisë për vitin 2022. Kontributi i rregullt, të cilin kompanitë që kryejnë sigurime të detyrueshme motorike janë të detyruara t'i paguajnë Shoqatës Kombëtare të Siguruesve të Malit të Zi për vitin 2022, u përcaktua si 3.91% e primeve të shkruara bruto në vitin 2021 nga sigurimi i detyrueshëm i aksidenteve të udhëtarëve në transportin publik; Sigurimi i përgjegjesisë së pronarëve/përdoruesve të mjeteve motorike dhe sigurimi i përgjegjesisë së pronarëve/përdoruesve të mjeteve lundruese, u përcaktua si 0.39% e primeve të shkruara bruto në vitin 2021 nga sigurimi i përgjegjesisë së pronarëve/përdoruesve të tyre.

Gjatë periudhës 11 mujore të vitit 2021, kompanitë e sigurimit realizuan prime të shkruara bruto në vlerën 90.3 milionë euro, 5.1% rritje krahasuar më të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rritën me 6.7%, ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ul me 1.1%.

Kryetari i Këshillit Drejtues të Agjencisë vuri në dukje se rezultati total për 11 muajt e 2021 tregon një rekord të mundshëm për të gjithë vitin, duke pasur parasysh se viti 2019 ishte një vit rekord dhe në 2020 kishte një rënie të lehtë në krahasim me vitin para pandemisë. "Të dhënat tregojnë se tregu po zhvillohet dhe po tregon elasticitet ndaj goditjeve të jashtme dhe të brendshme, por Agjencia vazhdon të intensivikojë aktivitetet e saj për ruajtjen e stabilitetit të tregut, duke pasur parasysh mundësinë që efektet negative të pandemisë në tregun e sigurimeve të shfaqen me kalimin e kohës".

## MAQEDONIA E VERIUT

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të tregut të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë së Veriut siguruesit maqedonas gjatë periudhës 9-mujore 2021 realizuan një vëllim primesh prej rreth 143 milionë euro, ose 17.4% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Primet e shkruara bruto në Sigurimin e Jo-Jetës zinin rreth 85% të primeve totale ose rreth 121.6 milionë euro. Në sigurimet e Jo-Jetës sigurimi MTPL zinte 41.7% të totalit, sigurimi i pronës zinte 20.9%.

Gjatë periudhës 9-mujore janar – shtator 2021, sigurimi i Jetës në tregun e Maqedonisë së Veriut u rrit me 12% në terma vjetorë, duke arritur në rreth 21.5 milionë euro. Sipas të dhënave zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve (ISA), deri në fund të shtatorit 2021, mbi 242 mijë qytetarë kishin polica të sigurimit të Jetës.

## POLONI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të shtatorit 2021, sipas shifrave të publikuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Polake (KNF), tregu polak i sigurimeve arriti në 50.9 miliardë PLN ose rreth 10.9 miliardë euro. Këto shifra tregojnë për një rritje të primeve prej rreth 7% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Dëmet e paguara bruto gjithashtu shënuan rritje për këtë periudhë me 2.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 30.2 miliardë PLN ose rreth 6.5 miliardë euro.

Në sigurimin e Jetës, u shënuar rritje të primeve të shkruara bruto me 7.4% duke arritur në vlerën e 16.6 miliardë PLN. Rritje pësuan edhe pagesat e dëmeve me 5.5% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke arritur në 13.5 miliardë PLN.

Në fund të shtatorit 2021, në vend kishte rreth 9.6 milionë polica individuale aktive të sigurimit të Jetës, përkundrajt 9.08 milionë polica një vit më parë. Deri në fund të shtatorit 2021, kishte 578 mijë kontrata sigurimi Jete në grup të cilat gjeneruan 2,654 milionë PLN. Numri i policave aktive të sigurimit shëndetësor individual është rritur me rreth 40%, duke arritur në pothuajse 2.3 milionë polica sigurimi.

Në sigurimin e Jo-Jetës, vëllimi i primeve të shkruara bruto arriti në 34.3 miliardë PLN dhe dëmet e paguara arritën në 16.7 miliardë PLN. Klasat e sigurimeve motorike, sigurimi MTPL dhe sigurimi Kasko, zunë peshën më të madhe:

- Primet e shkruara bruto të MTPL arritën në 11.1 miliardë PLN dhe dëmet bruto 6.7 miliardë PLN;
- Primet e shkruara bruto të sigurimit Kasko arritën në 7.0 miliardë PLN dhe dëmet bruto 4.3 miliardë PLN.

Pavarësisht rritjes së kostos së dëmeve, primi mesatar në sigurimin MTPL pësoi rënie. Në fund të tremujorit të tretë 2021, primi MTPL arriti në 486.8 PLN, që përfaqëson një rënie prej 2% krahasuar me një vit më parë. Në të njëjtën kohë, pagesa mesatare e dëmeve MTPL u rrit me 5.7%, duke arritur në 8367.7 PLN.

## SLLOVENI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas raporteve të publikuar nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, tregu slloven i sigurimeve në fund të tremujorit të tretë 2021 realizoi 2.03 miliardë euro prime duke shënuar një rritje prej 3.29% në terma vjetore. Sa i përket dëmeve të paguara, vlera e përgjithshme ishte rreth 1.18 miliardë euro, nga të cilat rreth 387 milionë euro dëmshpërblime për kontratat e sigurimit të Jetës dhe 803 milionë euro pagesa që lidhen me sigurimet e Jo-Jetës.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 2.77% në terma vjetore duke arritur në 527.44 milionë euro, ndërsa tregu i sigurimeve të Jo-Jetës raportoi një normë pozitive rritjeje prej 3.50% duke arritur në 1.46 miliardë euro. Sigurimet e Jo-Jetës zenë 71.90% të primeve të shkruara bruto totale për të gjitha klasat dhe segmentet e sigurimeve.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)